

Ndarja e Përgjegjësive në Inspektim në mes të Niveleit Qendror dhe Lokal

Korrik 2015

Shembulli i Inspektoratit të Tregut dhe Inspektoratit Sanitar



Hyrje

Inspektoratet janë trupa ekzekutiv dhe administrativ, kryesisht në kuadër të ministrive, të cilët kujdesen për zbatimin e ligjeve dhe akteve tjera nën ligjore që mbulojnë një fushë të caktuar. Në Kosovë nuk ka një ligj unik për organizimin dhe funksionimin e inspektorateve, me të cilin do të rregullohej edhe ndarja e përgjegjësiive në inspektim në mes të inspektorateve si pjesë e ministrive në nivel qendror, dhe drejtorive të inspektionit në nivel lokal. Si pasojë, secili inspektorat ka një bazë të veten ligjore (qoftë ligj, rregullore, udhëzim administrativ apo vendim) i cili përcakton organizimin dhe funksionimin e tij, dhe në këtë kuadër edhe shtrirjen e kompetencave nga niveli qendror në atë lokal.

Nëse analizojmë nga ky aspekt, inspektoratet në Kosovë mund të grupohen në tri grupe:

- 1) Inspektorate që funksionojnë vetëm në nivel qendror;
- 2) Inspektorate që, përveç nivelit qendror, funksionojnë edhe me zyra rajonale; dhe
- 3) Inspektorate që përveç nivelit qendror dhe rajonal, mbulojnë edhe nivelin lokal. Këto tri grupe përbëjnë një numër prej 18 inspektorateve, që numërojnë rreth 800 punëtorë, dhe që kujdesen për zbatimin e rreth 140 ligjeve. Në mars 2014, Instituti GAP ka publikuar një punim mbi organizimin dhe funksionimin e të gjitha inspektorateve në Kosovë.¹

Mirëpo, në disa raste, ekzistojnë konflikte kompetencash në mes të nivelit qendror dhe lokal. Për të ilustruar këtë konflikt, kemi marr shembullin e inspektoratit të tregut dhe atij sanitar. Përkundër asaj se fushëveprimtaria e këtyre dy inspektorateve rregullohet me ligje, në praktikë janë hasur pengesa të shumta në mes të inspektorëve të nivelit qendror dhe atyre lokal.

Sipas Ligjit për Inspektoratin e tregut, inspektorët komunal të tregut kalojnë në Inspektoratin e tregut në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI),² derisa me Ligjin për Ushqimin i vitit 2009 me të cilin është themeluar Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) si agjenci ekzekutive në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, inspektorët sanitar, fito-sanitar dhe veterinar në nivel lokal kalojnë në AUV.³

¹ Instituti GAP, Inspektoratet në Kosovë: organizimi dhe funksionimi, mars 2014: <http://bit.ly/1AaErPt>

² Ligji Nr. 03/L-181 për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut: <http://bit.ly/1lyZots>

³ Ligji Nr. 03/L-016 për ushqimin: <http://bit.ly/1pKWEvH>

Edhe pse me ligje precizohet kështu, në praktikë, inspektorët e tregut, dhe sanitar, fito-sanitar dhe veterinar funksionojnë ende në kuadër të komunave.

Qëllimi i këtij punimi është analizimi i situatës aktuale sa i përket ndarjes së përgjegjësive në inspektim në mes të inspektoratit të tregut (MTI) dhe inspektoratit të AUV me nivelin lokal, përkatësisht me drejtoritë e inspeksionit të cilat kanë numër të ndryshëm të inspektorëve të tregut, sanitar, fito-sanitar dhe veterinar. Për të pasur një pasqyrë të qartë të situatës aktuale, Instituti GAP ka kontaktuar inspektoratet përkatëse në nivel qendror dhe lokal, dhe ka analizuar të gjithë legjislacionin i cili definon këtë çështje.

1. Inspektimi i tregut: ndërveprimi në mes të inspektoratit të tregut (MTI) dhe inspektorëve të tregut në nivel lokal

Inspektimi i tregut dhe ndarja e përgjegjësive në mes të inspektoratit të tregut në kuadër të MTI dhe inspektorëve lokal të tregut, është rregulluar fillimisht me Ligjin për Inspeksionin e tregut në vitin 2005.⁴ Sipas këtij ligji, punët e inspeksionit të tregut të shkallës së parë i kryen inspektori komunal, derisa ato të shkallës së dytë i kryen inspeksioni i themeluar në kuadër të MTI.⁵

Një vit më vonë, përgatitur nga departamenti i ndërtimit dhe propozuar nga MTI, është miratuar Ligji për themelimin e Inspektoratit të Produkteve të Ndërtimit si pjesë e inspektoratit të tregut.⁶ Megjithatë, sipas inspektoratit të tregut, ky departament ka kaluar në Ministri të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) derisa një inspektor i produkteve të ndërtimit kishte kaluar në sektorin për siguri të produkteve në inspektoratin e tregut në kuadër të MTI.⁷

⁴ Ligji Nr. 02/L-1 për Inspeksionin e tregut: <http://bit.ly/1nCYOQa>

⁵ Ligji Nr. 02/L-1 për Inspeksionin e tregut, Neni 3.

⁶ Ligji Nr. 02/L-62 për Inspektoratin e Produkteve të Ndërtimit, Neni 4: <http://bit.ly/1rMGnuW>

⁷ Intervistë me Muharrem Pozhegu, ish-Kryeinspektor dhe Lebibe Haliti, Udhëheqëse e Sektorit për Çështje Juridike në Inspektoratin e Tregut, 14 Nëntor 2013.

Kjo ndarje e përgjegjësive në inspektimin e tregut në mes të inspektorëve lokal dhe inspektoratit të tregut në MTI ka vazhduar deri në vitin 2010, kur është nxjerrë Ligji për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut i cili shfuqizoi ligjin paraprak dhe integronte inspektorët lokal të tregut në inspektoratin e tregut në kuadër të MTI.⁸

Sipas këtij ligji dhe Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Inspektoratin e Tregut,⁹ inspektorët e tregut i takojnë vetëm nivelit qendror, përkatësisht inspektoratit të tregut në MTI. Megjithatë, në praktikë ky rregull i përcaktuar me ligj nuk është respektuar nga komunat. Kalimi i inspektorëve nën përgjegjësi të inspektoratit të tregut në MTI është refuzuar nga niveli lokal, dhe se buxheti i ndarë nga niveli qendror për komuna ku përfshihen edhe këta inspektorë nuk ka kaluar asnjëherë si buxhet i ndarë në kuadër të buxhetit për inspektoratin e tregut në MTI. Si pasojë e kësaj, inspektorët lokal të tregut vazhdojnë të paguhen në kuadër të komunës (kryesisht Drejtorisë së Inspektionit), dhe funksionojnë në kuadër të saj.

Në bazë të kësaj ndarje që ekziston në praktikë, nuk është e qartë se kush është institucioni që i obligon me punë këta inspektorë (komuna apo inspektorati i tregut në MTI), kujt i raportojnë ata, dhe si bëhet ndarja e subjekteve ekonomike për tu inspektuar në mes të inspektorëve të tregut në nivel lokal dhe inspektoratit të tregut në MTI. Megjithatë, sa i përket ngarkimit me punë dhe raportimit të inspektorëve, sipas Inspektoratit të Tregut, këta inspektorë pranojnë instruksione edhe nga inspektorati i tregut në MTI dhe raportojnë në këtë inspektorat ngase secili sektor regional ka nga një udhëheqës i cili i raporton Kryeinspektorit në inspektoratin e tregut në MTI.¹⁰

Inspektorati i tregut në MTI përbëhet nga zyra e Kryeinspektorit e cila numëron dy punonjës (Kryeinspektori dhe një zyrtar i nivelit teknik-administrativ), sektori për sigurinë e produkteve, sektori për çështje juridike, sektori për punë të përgjithshme të cilët numërojnë gjithsejtë 14 punëtorë, dhe shtatë sektorë të mbikëqyrjes inspektuese

⁸ Ligji Nr. 03/L-181 për Inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut, Nenet 38 dhe 39: <http://bit.ly/1lyZots>. Titulli i ligjit në "ligj për inspektoratin e tregut" dhe disa ndryshime tjera jo substanciale ishin bërë me plotësim ndryshimin e këtij ligji në vitin 2013, kur ishte nxjerrë edhe Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Inspektoratin e Tregut.

⁹ Vendimi i Qeverisë 01/161, i datës 27.03.2013: <http://bit.ly/1rMGvL0>.

¹⁰ Intervistë me Lulzim Syla, Kryeinspektor i Inspektoratit të Tregut në MTI, 14.07.2014.

të vendosur në shtatë regjione të Kosovës të cilët numërojnë 66 inspektorë. Gjithsejtë 82.

Ndarja sipas shtatë sektorëve inspektues në shtatë regjione të Kosovës, është me sa vijon:

1. Sektori i mbikëqyrjes inspektuese në Prishtinë dhe rrethinë (Fushë Kosovë, Lipjan, Obiliq, Drenas, Podujevë dhe Graçanicë);
2. Sektori i mbikëqyrjes inspektuese në Mitrovicë me rrethinë (Vushtrri, Skenderaj, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan);
3. Sektori i mbikëqyrjes inspektuese në Pejë dhe rrethinë (Istog, Klinë, Deçan dhe Junik);
4. Sektori i mbikëqyrjes inspektuese në Gjakovë dhe rrethinë (Malishevë dhe Rahovec);
5. Sektori i mbikëqyrjes inspektuese në Prizren dhe rrethinë (Dragash, Suharekë dhe Mamushë);
6. Sektori i mbikëqyrjes inspektuese në Gjilan dhe rrethinë (Viti, Kamenicë, Partesh, Ranillug, Klllokot dhe Novobërdë);
7. Sektori i mbikëqyrjes inspektuese në Ferizaj dhe rrethinë (Kaçanik, Shtime, Hani i Elezit dhe Shtërpçë);

2. Inspektimi Sanitar, Fito-sanitar dhe Veterinar: ndërveprimi në mes të inspektoratit të AUV dhe inspektorëve në nivel lokal

Inspektimi sanitar, fito-sanitar dhe veterinar fillimisht ishte rregulluar me legjislacion të ndarë dhe me përgjegjësi të ndara në disa institucione. Në vitin 2001, me anë të dy Rregulloreve të UNMIK-ut u themeluan Inspektorati fito-sanitar dhe fito-sanitar kufitar.¹¹ Më 2003 u themelua Inspektorati sanitar në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë (MSH),¹² dhe më 2004 u nxorr Ligji për Veterinarinë me anë të të cilit themelohej Shërbimi Veterinar dhe Ushqimit të Kosovës (SHVUK) në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR).¹³

¹¹ Rregullore e UNMIK-ut 2001/03 për themelimin e Inspektoratit fito-sanitar dhe 2001/07 për themelimin e inspektoratit fito-sanitar kufitar, datë 29 Maj 2001.

¹² Ligji Nr. 2003/22 për Inspektoratin sanitar të Kosovës: <http://bit.ly/1o3hQPk>

¹³ Ligji Nr. 2004/21 për Veterinarinë: <http://bit.ly/1W8BfC>. SHVUK-ut më vonë i është referuar edhe si Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Kosovës (AVUK).

Kjo ndarje e përgjegjësi në inspektim në fushat përkatëse ka vazhduar deri në vitin 2009 kur është nxjerrë Ligji për Ushqimin i cili krijoi edhe Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) si agjenci ekzekutive në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.¹⁴ Në bazë të këtij ligji, AUV-it i duhet t'i bashkohen:

- AVUK
- Inspektorati sanitar në kuadër të MSH
- Inspektorati fito-sanitar dhe fito-sanitar kufitar, dhe
- Inspektoratet komunale të këtyre shërbimeve.¹⁵

Me nxjerrjen e këtij ligji është bërë një unifikim i bazës ligjore dhe institucionale duke krijuar kështu Inspektoratin e AUV i cili përbëhet nga inspektorati sanitar, fito-sanitar dhe veterinar,¹⁶ e të cilët në përbërje të tyre kanë edhe degët e inspektoratit fito-sanitar kufitar dhe veterinar kufitar.¹⁷ Pa llogaritur nivelin lokal, AUV me degët e saj ka 77 inspektorë sanitar, fitosanitar (kufitar) dhe veterinar (kufitar).

Mirëpo, edhe pse Ligji për ushqimin ka përcaktuar që inspektoratet komunale të këtyre shërbimeve të bashkohen nën AUV dhe zgjedhjen e inspektorëve e bën kjo agjenci,¹⁸ inspektoratet komunale ende funksionojnë në kuadër të komunave, zgjedhen nga komunat dhe paguhen në kuadër të komunave.¹⁹

Megenëse në praktikë inspektorët e fushave përkatëse funksionojnë në kuadër të komunave, nuk është e qartë se kush i ngarkon me punë dhe kujt i raportojnë këta inspektorë.

3. Numri i inspektorëve të tregut dhe sanitar, fito-sanitar dhe veterinar

Sipas Rregullores për organizimin e brendshëm të inspektoratit të tregut, numri prej 66 inspektorëve në shtatë sektorët e mbikëqyrjes inspektive të vendosur në shtatë regjione të Kosovës ka këtë

¹⁴ Ligji Nr. 03/L-016 për Ushqimin, Neni 36: <http://bit.ly/1pKWEvH>

¹⁵ Ligji Nr. 03/L-016 për Ushqimin, Neni 39.

¹⁶ Ligji Nr. 03/L-016 për Ushqimin, Neni 24.

¹⁷ Faqja zyrtare e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV): <http://bit.ly/1pq6ULk>

¹⁸ Ligji Nr. 03/L-016, Neni 24, pika 2.

¹⁹ Intervistë me Ilirjana Zymberaj, Drejtoresh e Inspektoratit të AUV, 05.11.2013, dhe Ismet Fejzullahu, Shef i Inspektoratit fito-sanitar në AUV, 25.06.2015.

shpërndarje: Prishtina me rrethinë ka 15 inspektorë, Mitrovica me rrethinë 8 inspektorë, Peja me rrethinë 9 inspektorë, Gjakova me rrethinë 8 inspektorë, Prizreni me rrethinë 9 inspektorë, Gjilani me rrethinë 11 inspektorë dhe Ferizaj me rrethinë 6 inspektorë.²⁰

Mirëpo, meqë kjo rregullore nuk tregon se sa inspektorë të tregut ka secila komunë, dhe as nuk dihet numri i inspektorëve sanitar, fito-sanitar dhe veterinar po ashtu në secilën komunë, Instituti GAP ka kontaktuar të gjitha komunat për të parë numrin e saktë të inspektorëve të këtyre fushave në secilën komunë, dhe nëse ky numër është në proporcion me subjektet që kanë nën inspektim.

Tabela 1: Numri i inspektorëve të tregut dhe sanitar, fito-sanitar (kufitar) dhe veterinar (kufitar)²¹

| Nr. | Komunat | Inspektor të tregut | Inspektor sanitar | Inspektor fito-sanitar | Inspektor veterinar |
|-----|--------------------|---------------------|-------------------|------------------------|---------------------|
| 1. | Deçan | 1 | 1 | - | - |
| 2. | Dragash | 1 | 1 | - | 1 |
| 3. | Ferizaj | 2 | 5 | - | 2 |
| 4. | Fushë Kosovë | 2 | 1 | - | 1 |
| 5. | Gjakovë | 1 | 2 | - | 1 |
| 6. | Gjilan | 4 | 3 | 1 | 1 |
| 7. | Gllgovc | 2 | 1 | - | - |
| 8. | Hani i Elezit | 1 | 1 | - | - |
| 9. | Graçanicë | 2 | 1 | - | - |
| 10. | Istog | 1 | 1 | 1 | 1 |
| 11. | Junik | 1 | 1 | - | - |
| 12. | Kaçanik | 1 | 1 | - | - |
| 13. | Kamenicë | 3 | 3 | 1 | 1 |
| 14. | Klinë | 2 | 1 | - | - |
| 15. | Klllokot | 1 | 1 | - | - |
| 16. | Leposaviq | - | - | - | - |
| 17. | Lipjan | 1 | 1 | 1 | - |
| 18. | Malishevë | 1 | 1 | 1 | 1 |
| 19. | Mamushë | 1 | 1 | - | - |
| 20. | Mitrovica e Jugut | 5 | 6 | - | 1 |
| 21. | Mitrovica e Veriut | - | - | - | - |
| 22. | Novobërdë | - | 1 | - | - |
| 23. | Obiliq | 1 | 1 | - | - |
| 24. | Partesh | 1 | 1 | 1 | - |
| 25. | Pejë | 4 | 3 | - | 1 |
| 26. | Podujevë | 4 | 1 | - | 1 |
| 27. | Prishtinë | 1 | 5 | - | 1 |
| 28. | Prizren | 5 | 4 | 3 | 4 |
| 29. | Rahovec | 3 | 1 | - | 1 |

²⁰ Rregullore Nr. 10/2013 mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Inspektoratin e tregut: <http://bit.ly/1FCH1wz>

²¹ Kontaktet nëpër komuna mbi numrin e inspektorëve të fushave përkatëse janë realizuar në pjesën e dytë të 2014.

| | | | | | |
|--------------|-------------|------------------|----|------------------|----|
| 30. | Ranillug | - | - | - | - |
| 31. | Shtërrpcë | - | 2 | - | - |
| 32. | Shtime | 1 | 1 | - | - |
| 33. | Skenderaj | 1 | 1 | - | - |
| 34. | Suharekë | 2 | 1 | 1 | 1 |
| 35. | Viti | 2 | 1 | 1 | 1 |
| 36. | Vushtri | 4 | 1 | - | 1 |
| 37. | Zubin Potok | - | - | - | - |
| 38. | Zveçan | - | - | - | - |
| Niveli lokal | | 62 | 57 | 11 ²² | 21 |
| Qendror | | 12 ²³ | 16 | 14 | 11 |
| Kufitar | | - | - | 21 | 15 |
| Totali | | 74 | 73 | 46 | 47 |

Siç shihet nga tabela, numri i inspektorëve të tregut që kanë deklaruar komunat (62) është për katër më pak se numri i tyre që ka deklaruar inspektorati i tregut në MTI të ndarë në shtatë sektorë regional (66). Përveç komunave veriore (Mitrovica e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan), komunat si Shtërrpca, Ranillugu dhe Novobërda nuk kanë deklaruar ndonjë inspektor të tregut, derisa numri më i madh i inspektorëve të tregut që kanë komunat janë: Prizreni dhe Mitrovica me nga pesë inspektorë, pastaj Gjilani, Peja, Podujeva me nga katër inspektorë, Kamenica dhe Rahoveci me nga tre inspektorë, shtatë komuna me nga 2 inspektorë, dhe shumica e komunave me nga një inspektorë. Si shembull, Prishtina ka vetëm një inspektor të tregut dhe bën pjesë në grupin e komunave me nga një inspektor të tregut.

Sipas ligjit, *“inspektorati i tregut ka për kompetencë që të inspektojë standardet e tregtimit të mallrave dhe të cilësisë së shërbimeve që ofrojnë subjektet ekonomike në territorin e Republikës së Kosovës”*²⁴. Nëse i referohemi të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) për numrin mesatar prej rreth 29,057 të ndërmarrjeve aktive çdo vit për periudhën 2008-2013, dhe krahasojmë me numrin prej 74 inspektorëve të tregut, vërehet se numri i tyre është shumë i vogël në

²² Komunat kanë deklaruar këtë numër të inspektorëve fito-sanitar. Megjithatë, sipas AUV, numri i këtyre inspektorëve nëpër komuna është 24 të quajtur si inspektor bujqësor ngase komunat nuk kanë inspektorë fito-sanitar. Takim/intervistë me Ismet Fejzullahu, Shef i Inspektoratit fito-sanitar në AUV, 25.06.2015.

²³ Nga numri prej 14 të punësuarve në tre sektorët e Inspektoratit të Tregut në MTI, sa është i paraparë me Rregulloren 10/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Inspektoratin e Tregut, 12 janë inspektorë (5 inspektorë të naftës, 4 të tregut të përgjithshëm, dhe 3 të sigurisë së produkteve). Takim/intervistë me Remzi Hoxha, Inspektor i Lartë në Inspektoratin e Tregut në MTI, 23.06.2015.

²⁴ Ligji Nr. 03/L-181 për Inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut, Neni 9 - kompetencat e inspektoratit të tregut: <http://bit.ly/1lyZots>

krahasim me subjektet ekonomike nën inspektim.²⁵ Sipas kësaj, një inspektor i tregut i bie që të inspektojë 392 subjekte ekonomike në vit, apo 32 në muaj.

Gjendje jo më e mirë sa i përket numrit të inspektorëve paraqitet edhe me inspektorët sanitar, fito-sanitar dhe veterinar. Siç vërehet nga tabela, numri i inspektorëve sanitar në nivel qendror dhe lokal është 73, inspektorëve fito-sanitar në nivel qendror, lokal dhe kufij është 46 dhe i atyre veterinar 47. Megjithatë, sipas inspektoratit të AUV, numri i inspektorëve është i pa mjaftueshëm ngase inspektorët e nivelit lokal nuk i përgjigjen nivelit qendror, dhe si pasojë e kësaj duhet të shtohet numri i inspektorëve sanitar, fito-sanitar dhe veterinar në nivel qendror.²⁶

Deri në fillim të 2014, një karakteristikë në mes të inspektoratit të tregut dhe inspektoratit të AUV (inspektoratit sanitar) ka qenë edhe konflikti në kompetenca krijuar me dy Udhëzime Administrative të nxjerra me 2005 dhe 2007, derisa ligjet apo baza ligjore në bazë të të cilave ushtronin funksionin inspektorati i tregut dhe ai i AUV janë Ligji për Inspektoratin e Tregut nxjerrë më 2010 dhe Ligjin për Ushqimin nxjerrë më 2009. Në njërin anë, në kohën kur inspektorati sanitar ka qenë pjesë e MSH, më 2005 ishte nxjerrë Udhëzimi Administrativ për “etiketimin e produkteve ushqimore”,²⁷ derisa në anën tjetër, MTI në vitin 2007 kishte nxjerrë Udhëzimin Administrativ për “etiketën dhe deklarimin e mallit”.²⁸ Edhe pse ky i fundit ishte plotësuar ndryshuar më 2009,²⁹ ky konflikt në kompetenca në mes të këtyre dy inspektorateve nuk ishte zgjidhur. Megjithatë, sipas Inspektoratit të Tregut në MTI,³⁰ ky konflikt në kompetenca është zgjidhur me nxjerrjen e Rregullores 09/2013 për Etiketimin, Prezantimin dhe Reklamimin e Produkteve Ushqimore.³¹

²⁵ Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK), Rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve 2008-2013, f.10: <http://bit.ly/1E3yLan>

²⁶ Intervistë me Ilirijana Zymberaj, Drejtoresh e Inspektoratit të AUV, 05.11.2013, dhe Ismet Fejzullahu, Shef i Inspektoratit fito-sanitar në AUV, 25.06.2015.

²⁷ Udhëzim administrativ (MSH) Nr. 12/2005 për etiketimin e produkteve ushqimore: <http://bit.ly/1knUGnL>

²⁸ Udhëzim administrativ Nr. 2007/05 për etiketën dhe deklarimin e mallit: <http://bit.ly/1lfefJO>

²⁹ Udhëzim administrativ Nr. 2009/21 për plotësimin dhe ndryshimin e udhëzimit administrativ Nr. 2007/05 për etiketën dhe deklarimin e mallit:

<http://bit.ly/1s5XCpD>

³⁰ Bisedë përmes telefonit me Lebibe Haliti, Udhëheqëse e Sektorit për Çështje Juridike në Inspektoratin e Tregut, 26.06.2015.

³¹ Rregullore (MTI) Nr. 09/2013 për Etiketimin, Prezantimin dhe Reklamimin e Produkteve Ushqimore: <http://bit.ly/1fif0tN>. Me këtë Rregullore janë shfuqizuar dy Udhëzimet Administrative 2007/05 dhe 2009/21 cekur më lartë.

4. Përfundime dhe rekomandime

Ekziston një përzierje e përgjegjëseve inspektuese në mes të nivelit qendror dhe lokal. Shkak për këtë është refuzimi i nivelit lokal për të implementuar Ligjin për inspektoratin e tregut dhe Ligjin për ushqimin, të cilët specifikojnë se inspektorët përkatës kalojnë nën përgjegjësi të nivelit qendror, përkatësisht në inspektoratit të tregut dhe inspektoratit të AUV.

Këtij konflikti i kontribuon edhe fakti që Ministria e Financave vazhdon të ndajë buxhet edhe për inspektorët lokal të fushave përkatëse, edhe pse me ligjet përkatëse, një buxhet i tillë do të duhej të ndahej për inspektoratin e tregut dhe inspektoratin e AUV. Si pasojë e mungesës së një ligji të vetëm për organizimin dhe funksionimin e inspektorateve, secili ligj apo legjislacion që shërben si bazë për organizimin dhe funksionimin e një inspektorati, përcakton në mënyrën e vet organizimin, funksionimin, dhe shtrirjen e kompetencave të një inspektorati.

Sa i përket numrit të inspektorëve të tregut, dhe sanitar, fito-sanitar dhe veterinar, krahasuar me subjektet që janë nën përgjegjësi të tyre për inspektim, mund të përfundohet se ekziston një mungesë e inspektorëve në këto inspektorate.

Në bazë të analizës së kësaj situatë, dhe përfundimeve, Instituti GAP rekomandon marrjen e këtyre hapave:

- **Qeveria** e Kosovës duhet të kthejë Projektligjin për inspektim, dhe në vend të tij të hartojë Projektligjin për inspektorate;
- **MTI** me inspektoratin e tregut në kuadër të saj, dhe me përfshirje të institucioneve të kësaj fushe në nivel lokal, duhet të bëjnë një analizë mbi atë se cila mënyrë është më efektive, ajo e mbajtjes së inspektorëve të tregut nën përgjegjësi të nivelit qendror, apo kthimit të këtyre inspektorëve nën përgjegjësi të nivelit lokal (drejtorive të inspektionit);
- **AUV** dhe drejtoritë e inspektionit në nivel lokal, duhet të bëjnë një analizë mbi atë se cila mënyrë është më efektive, ajo e mbajtjes së inspektorëve sanitar, fito-sanitar dhe veterinar nën përgjegjësi të nivelit qendror, apo kthimit të këtyre inspektorëve nën përgjegjësi të nivelit lokal;

- **Inspektorati i tregut** dhe inspektorati i AUV duhet të shikojnë mundësinë e rritjes së numrit të inspektorëve për të rritur nivelin e mbikëqyrjes inspektuese dhe me këtë edhe nivelin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve në këto fusha.



Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtite në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtite në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Institute for Advanced Studies GAP is supported by:



Ky projekt është mbështetur nga:

